



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
GRAMSH

Nr. 8645/12 Prot.

Gramsh, më: 31/12/2018.

VENDIM

Nr. 97 datë: 27 / 12 / 2018.

PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS SË BASHKISË GRAMSH

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e datës: 27 / 12 / 2018 , pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur, “Për miratimin e Programit të Transparencës së bashkisë Gramsh” dhe bazuar në nenin 9, 15 dhe 18/3 të ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në nenin 4 të ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” si dhe në programin model të miratuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

- 1- Të miratoj Programin e Transparencës së bashkisë Gramsh.
- 2- Kryetari i Bashkisë vlerëson dhe mbikëqyr të gjithë procesin e zbatimit të Programit të Transparencës nga ana e administratës së bashkisë, njërive administrative dhe njërive të varësisë.
- 3- Monitorimi i zbatimit të Programit të Transparencës do të bëhet jo më pak se njëherë në vit nga ana e Këshillit Bashkiak dhe Kryetarit të Bashkisë.
- 4- Brenda 10 ditëve nga data e miratimit nga ana e Këshillit Bashkiak, Programi i Transparencës publikohet në faqen zyrtare të internetit të bashkisë, në një menu të veçantë të titulluar “Programi i Transparencës” në vendet e caktuara për njoftimet publike të bashkisë dhe njërive administrative.

SEKRETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Astrit DUZHA

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Shkëlqim HOXHA

Konc.Dact. A. Duzha

Konfirmoi: Sh.Hoxha

Miratoi: Sh.Hoxha

Dosja nr _____

Afati i ruajtjes: RHK

